

PROJEKTLIGJ

Nr. ____/2020

PËR

GARDËN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozim të Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

V E N D O S I:

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

Ky ligj përcakton misionin, organizimin, funksionimin, detyrat, të drejtat dhe statusin e Gardës së Republikës, si dhe rregullon veprimtarinë, marrëdhëniet e punës, garantimin e karrierës, mirëqënies dhe vazhdimësisë në detyrë të punonjësit të tij.

Neni 2

Misioni

Misioni i Gardës së Republikës është garantimi i sigurisë së personaliteteve shtetërore dhe objekteve në ruajtje, në zbatim të ligjit, në përputhje me Kushtetutën dhe aktet e njohura ndërkombëtare, duke respektuar të drejtat dhe liritë e njeriut.

Neni 3

Statusi

Garda e Republikës është institucion i administratës shtetërore, person juridik, në varësi të ministrit përgjegjës për çështjet e rendit dhe sigurisë publike.

- i Punonjësi, për shkak të veçorive të detyrës si dhe të rrezikut të jetës e të shëndetit të tij, gëzon status të veçantë.
- i Punonjës të Gardës, në funksione të veçanta në përbërje të institucionit, bazuar në përcaktimet e këtij ligji, gëzojnë atributet e punonjësit të policisë gjyqësore në përputhje

me Kodin e Procedurës Penale dhe Ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”.

Neni 4 **Parimet e veprimtarisë**

Parimet bazë të organizimit dhe funksionimit të Gardës së Republikës janë:

- i ligjshmëria;
- i besueshmëria dhe integriteti;
- i profesionalizmi dhe merita;
- i uniteti dhe hierarkia;
- i ruajtja e informacionit të klasifikuar;
- i pavarësia operationale, bashkëpunimi dhe bashkëveprimi.

Neni 5 **Përkufizime**

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- i **“Armatim dhe pajisje personale”** konsiderohen armët, pajisjet dhe mjetet individuale të përcaktuara për çdo funksion në Tabelën e Organizimit dhe të Pajisjeve të strukturave të Gardës së Republikës
- i **“Armatim dhe pajisje kolektive”** konsiderohen armët, pajisjet dhe mjetet për përdorim kolektiv nga strukturat e Gardës së Republikës, të përcaktuara në Tabelën e Organizimit dhe të Pajisjeve të tyre.
- i **“Gatishmëri”** janë nivelet e ndryshme të gjendjes në të cilën strukturat e Gardës zhvillojnë aktivitetin dhe marrin masa përkatëse për sigurinë e personaliteteve, objekteve në ruajtje dhe të detyrave të tjera ligjore, të përcaktuara në Rregulloren e Gardës së Republikës.
- i **“Gradë”** është titulli dhe shenja dalluese që ndan nivelet e hierarkisë të punonjësve të Gardës.
- i **“Informacion i klasifikuar”** është çdo njohuri që mund të komunikohet apo dokumentohet, pavarësisht nga forma, që është nën kontrollin e strukturave shtetërore dhe është i klasifikuar sipas legjislacionit në fuqi.
- i **“Ministri”** është Ministri përgjegjës për çështjet e rendit dhe të sigurisë publike.
- i **“Mbrotjtje”** është veprimtaria kryesore e personelit në detyrë si dhe e strukturave të Gardës për të garantuar paprekshmërinë e personaliteteve dhe objekteve në ruajtje nga kërcënimet, rreziqet dhe sulmet e mundshme.
- i **“Ruajtje”** është veprimtaria e përditshme që ka për qëllim mbikëqyrjen e personalitetit dhe objektit nga rreziqet e mundshme .
- i **“Objekt i Rëndësisë së Veçantë”** objekti i përcaktuar me VKM që për shkak të rëndësisë dhe veprimtarisë që zhvillohet në të, ruhet dhe mbrohet nga Garda.
- i **“Objekt në ruajtje”** nënkupton çdo ndërtesë dhe hapësirë private apo publike,

- segmete rrugore ku qëndrojnë, kalojnë dhe zhvillojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme apo të përkohshme personalitetet e vendit dhe të huaja. Këto objekte gëzojnë statusin e rëndësisë së veçantë për sa kohë merret në ruajtje nga personeli i Gardës.
- i **“Pajisje kufizuese”**, janë pajisjet që përdor Garda në situata të veçanta, më qëllim përmbushjen e misionit.
 - i **“Personalitete të larta shtetërore”** janë Presidenti i Republikës, Kryetari i Kuvendit dhe Kryeministri, si dhe homologët e tyre kur vizitojnë vendin tonë.
 - i **“Personalitete shtetërore”** janë personat e emëruar apo të zgjedhur që kryejnë funksione të një rëndësie të veçantë në Republikën e Shqipërisë, të përcaktuara me Vendim të Këshillit të Ministrave ose homologët e tyre kur vizitojnë vendin tonë.
 - i **“Punonjës i Gardës së Republikës”** është punonjësi me gradë marrëdhëniet e punës të së cilit rregullohen sipas këtij ligji
 - i **Punonjës Administrativ i Gardës së Republikës** është punonjësi pa gradë, marrëdhëniet e punës të së cilit rregullohen sipas Kodit të Punës.
 - i **“Përdorimi i forcës”** është veprimi i drejtpërdrejtë, i cili ushtrohet nëpërmjet forcës fizike, pajisjeve, mjeteve të tjera të posaçme në mënyrë proporcionale dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.
 - i **Siguria** është tërësia e masave të marra për të mbrojtur personalitetet dhe objektet në ruajtje.
 - i **“Situatë emergjente”**, një situatë e rrezikshme që përbën një kërcënim serioz, e cila ndikon ose mund të ndikojë drejtpërdrejt ose tërthorazi në sigurinë e personaliteteve dhe objekteve.
 - i **“Trajnim”** është përgatitja profesionale dhe fizike, në mënyrë periodike dhe të vazhduar, për të ruajtur dhe përmirësuar parametrat dhe performancën e punonjësve për përmbushjen e përgjegjësiave funksionale.
 - i **“Arsimim dhe kualifikim institucional”** është tërësia e njohurive dhe shprehive që u jepen punonjësve të Gardës së Republikës nëpërmjet kurseve, pjesë e strategjisë/politikave të arsimit të personelit të Gardës së Republikës.
 - i
 - i **“Vërtetim i besueshmërisë”** është dokument i cili pasqyron rezultatet e verifikimit të të dhënave të vetëdeklaruar në raport me ato të regjistruara fizikë dhe elektronikë të administruara nga Policia e Shtetit dhe institucione të tjera shtetërore. ë
 - i **“Veprimtari hetimorë”** është veprimtaria që kryhet në përputhje me Kodin e Procedurës Penale, nga punonjësit që gëzojnë atributet e Policisë Gjyqësore
 - i **“Verifikimi i pastërtisë së figurës së punonjësit”** është proces verifikimi, shqyrtimi dhe vlerësimi, që i referohet kryerjes së një kontrolli të kujdesshëm periodik për të gjithë punonjësit e Gardës dhe për raste të veçanta para emërimit të punonjësit në një detyrë të rëndësishme që kërkon ruajtjen e sekretit, besueshmërinë, besnikërinë e përshtatshmërinë për një detyrë që ka të bëjë me sigurinë e personaliteteve.

KREU II

ORGANIZIMI, VEPRIMTARIA DHE FUNKSIONIMI

Neni 6

Organizimi i Gardës së Republikës

- i Garda organizohet në struktura hierarkike në nivel drejtorie të përgjithshme, drejtorie, sektori, seksioni.
- i Struktura organike dhe numri i përgjithshëm i punonjësve të Gardës miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të Ministrit.

Neni 7

Detyrat

- i Garda ka përgjegjësi dhe kryen këto detyra kryesore:
 - i organizon dhe kryen ruajtjen dhe mbrojtjen fizike të personaliteteve;
 - i organizon dhe kryen ruajtjen, mbrojtjen e brendshme e të jashtme të objekteve;
 - i kryen shërbim ceremonial sipas përcaktimeve ligjore të ceremonialit shtetëror të Republikës së Shqipërisë;
 - i përcakton zonën e sigurisë, skemat e ruajtjes së bashku me planet e dislokimit, ato operacionale, si dhe vendos kontaktet me institucionet ligjzbatuese në interes të ruajtjes dhe mbrojtjes së personaliteteve dhe objekteve në ruajtje;
 - i parandalon rrezikun e çastit nga persona që tentojnë të çënojnë integritetin fizik të personaliteteve, që tentojnë të dëmtojnë imazhin e tyre apo dëmtojnë objektin në ruajtje;
 - i bën verifikimin e identitetit e personave para se të hyjnë në objektet në ruajtje;
 - i grumbullon dhe përpunon informacione nga struktura të tjera të sigurisë në vend ose nga burime të hapura me qëllim parandalimin e veprimtarisë kriminale dhe keqdashëse/keqbërëse ndaj personaliteteve dhe objekteve në ruajtje;
 - i grumbullon, vlerëson, analizon, shpërndan dhe përdor informacion për nevoja të parandalimit e zbulimit të autorëve të veprave penale ndaj personaliteteve të vendit dhe të huaja që vizitojnë vendin tonë;
 - i bën kontrollin fizik të personelit të administratës dhe të personave të tjerë si dhe të çdo bagazhi të tyre, para se të hyjnë në objektin që ka në ruajtje, për praninë e armëve e sendeve apo lëndëve të tjera me rrezik;
 - i kryen kontrollin paraprak dhe të vazhdueshëm të objekteve në ruajtje, hapësirave publike ose private, të pajisjeve, të mjeteve të transportit dhe të bagazheve në vendet që do të shkojë personaliteti;
 - i kryen kontrollin e dërgesave, pakove, dhuratave dhe sendeve të tjera në objektet në ruajtje, për praninë e lëndëve me rrezik, para se tu shkojnë personaliteteve;
 - i bllokun pjesë rrugësh ose mjedise publike apo private, ndalon dhe urdhëron zhvendosjen e mjeteve, nga vendparkimi për aq kohë sa është e nevojshme, për nevoja të sigurisë ose në kushtet e emergjencës, vetë ose në bashkëpunim me struktura të tjera ligjzbatuese;
 - i merr masa për bllokimin e valëve transmetuese për të gjitha pajisjet ose në mënyrë selektive në zonat ku personalitetet ushtrojnë aktivitet, kur e gjykon të

- domosdoshme;
- i merr masa për sigurinë e rendit në sallën e zhvillimit të seancave plenare të Kuvendit, ambientet e brendshme të Presidencës, Kuvendit, Kryeministrit, Ministrisë përgjegjëse për punët e jashtme;
 - i i bën të njohur personalitetit një situatë të pritshme rreziku për jetën, shëndetin, integritetin e tij dhe i sugjeron të mos zhvillojë aktivitetin, lëvizjen, qëndrimin, takimet dhe për këto raste Drejtori i Përgjithshëm i Gardës së Republikës informon Ministrin;
 - i bashkëpunon dhe bashkëvepron me Policinë e Shtetit dhe shërbimet inteligjente për ruajtjen e mbrojtjen e personaliteteve dhe objekteve në ruajtje., sipas rregullave të përcaktuara në akt të përbashkët të drejtueseve të strukturave;
 - i bashkëpunon me strukturat shtetërore që ofrojnë shërbimin e urgjencës dhe kujdesit parësor për personalitetet e larta të shtetit;
 - i bashkëpunon dhe bashkëvepron me persona fizik e juridik, shtetëror e privat për ruajtjen e mbrojtjen e personaliteteve dhe objekteve në ruajtje
 - i përdor pajisje të posaçme për kufizimin e veprimeve të personave që përbëjnë rrezik për personalitetin apo objektet në ruajtje;
 - i përdor armët e zjarrit në organikë të Gardës sipas legjislacionit në fuqi për përdorimin e armëve të zjarrit;
 - i vlerëson informacionin që përbën rrezik për personalitetet e objektet në ruajtje dhe në bashkëpunim me strukturat e Policisë së Shtetit, të Shërbimit Informativ të Shtetit dhe struktura të tjera ligjzbatuese, merr masat e nevojshme për shmangien e çdo veprimi të dëmshëm për personalitetin apo objektin.
 - i bashkëpunon me protokollin e shtetit dhe institucionet homologe të vendeve pritëse, përgjegjëse për sigurinë e personaliteteve, për organizimin e masave të sigurisë kur personaliteti qëndron jashtë vendit.
 - i Rregullat dhe procedurat për zbatimin e këtyre detyrave përcaktohen në Rregulloren e Gardës së Republikës.

Neni 8

Nivelet e Gatishmërisë

- i Garda e Republikës e kryen veprimtarinë dhe përmbush përgjegjësinë e saj duke u organizuar në këto nivele gatishmërie:
- i Niveli i gatishmërisë normale, “Jeshile” përcakton regjimin e punës apo shërbimit në situatë normale.
- i Niveli i gatishmërisë së përforcuar, “Portokalli” përcakton regjimin e punës me shërbim të përforcuar.
- i Niveli i gatishmërisë së lartë “E kuqe” përcakton shërbimin në situatë me rrisht të lartë, real dhe të vazhdueshëm.
- i Nivelet e gatishmërisë në Gardën e Republikës, mund të aktivizohen për të gjithë strukturat e saj ose për struktura të vecanta, bazuar në detyrat e marra dhe situatat e krijuara në kuadër të përmbushjeve të misionit nga ana e tyre.
- i Rregullat, procedurat dhe kompetencat për kalimin nga një nivel gatishmërie në tjetrin

përcaktohen me udhëzim të Ministrit.

Neni 9 **Bashkëpunimi**

- i Për përmbushjen e misionit Garda bashkëpunon me:
- i struktura të Ministrisë për çështjet e sigurisë dhe rendit publik;
- i shërbimin Informativ të Shtetit;
- i Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura;
- i protokollin e Shtetit, administratën e institucionit të Presidentit, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, protokollet dhe kabinetet e institucioneve të tjera;
- i strukturën përgjegjëse që ofron shërbimin e urgjencës dhe kujdesit parësor për personalitetet e larta të shtetit;
- i organet e ndryshme të administratës shtetërore
- i njësitë e qeverisjes vendore;
- i komunitetin, shoqërinë civile dhe shërbimet e sigurisë private;
- i me persona juridik e fizik dhe me çdo shtetas kur lind një nevojë e tillë;
- i shërbimet homologe të shteteve të huaja, në bazë të legjislacionit në fuqi dhe sipas protokolleve e marrëveshjeve ndërkombëtare.

Neni 10 **Detyrime të subjekteve shtetërore dhe private**

- i Protokollin e Shtetit dhe kabinetet e institucioneve të personaliteteve njoftojnë Gardën për kohën dhe vendin e zhvillimit të aktivitetit sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se 24 orë përpara fillimit të tij.
- i Strukturat shtetërore që ofrojnë shërbimin e urgjencës dhe kujdesit parësor për personalitetet e larta të shtetit dhe struktura që ka përgjegjësi për mirëqenien sociale të tyre, detyrohen të bëjnë verifikimin e besueshmërisë për punonjësit e tyre nëpërmjet Gardës.
- i Personat fizik dhe juridik, shtetëror apo privat janë të detyruar të mos pengojnë punonjësit e Gardës të kryejnë detyrat për mbrojtjen e personaliteteve të vendit dhe të huaja, në rastet kur është e nevojshme përdorimi i ambienteve në përdorim apo pronësi të tyre. Procedurat për kryerjen e veprimeve përcaktohen në Rregulloren e Gardës.
- i Të gjitha institucionet shtetërore detyrohen t'i japin menjëherë Gardës çdo informacion të mundshëm që rrezikon sigurinë e personaliteteve dhe të objekteve në ruajtje, sipas këtij ligji, kur aktiviteti i këtyre të fundit lidhet me institucionet shtetërore.

Neni 11 **Përgjegjësia e punonjësit**

Punonjësi i Gardës mban përgjegjësi administrative, civile dhe penale për kryerjen e çdo veprimi të kundërligjshëm apo mosveprimi gjatë ushtrimit të detyrës, sipas parashikimeve në legjislacionin përkatës në fuqi.

Neni 12 Kufizimet

- i Punonjësit i ndalohe:
- i anëtarësimi dhe pjesëmarrja në veprimtaritë e partive apo të shoqatave politike në çdo formë që shfaqen ato, në nivel qendror apo vendor, si dhe propaganda në favor ose kundër tyre apo kandidatëve në zgjedhje;
- i manifestimi i sjelljeve dhe mbajtja e qëndrimeve që çënojnë statusin e punonjësit të Gardës;
- i pjesëmarrja në grevë dhe në ankesat kolektive;
- i dalja jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për arsye vetjake, pa marrë më parë miratimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Gardës së Republikës;

KREU III

PERSONALITETET DHE OBJEKTET NË RUAJTJE E MBROJTJE

Neni 13

Personalitetet dhe objektet që ruhen e mbrohen nga Garda

- i Garda ruan dhe mbron:
- i Presidentin e Republikës së Shqipërisë, Kryetarin e Kuvendit, Kryeministrin, si dhe pjesëtarët e familjeve të tyre;
- i Presidentin e zgjedhur që nga momenti i betimit para Kuvendit,
- i Zëvendëskryetarin e Kuvendit, Zëvendëskryeministrin, Ministrin përgjegjës për çështjet e rendit dhe të sigurisë publike, Ministrin përgjegjës për punët e jashtme;
- i Kryetarin e Gjykatës Kushtetuese dhe Kryetarin e Gjykatës së Lartë.
- i Personalitete të tjera të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.
- i Personalitetet e huaja të të njëjtit nivel me personalitetet shqiptare të përmendura në pikën 1, gjerat “a” dhe “c”, të këtij neni, që vijnë për vizitë zyrtare në Republikën e Shqipërisë;
- i Personalitetet e huaja në vlerësim dhe kërkesë të Protokollit të Shtetit gjatë kohës së qëndrimit të tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- i Garda ruan dhe mbron:
- i Objektet ku ushtrojnë veprimtarinë dhe akomodohen Presidenti i Republikës, Kryetari i Kuvendit, Kryeministri, si dhe banesat ku ata banojnë apo akomodohen;
- i Objektet ku zhvillohen seancat plenare të Kuvendit dhe të komisioneve parlamentare;
- i Godinën e Ministrisë përgjegjëse për punët e jashtme;

- i Objektet ku akomodohen dhe zhvillojnë veprimtarinë personalitetet e huaja të të njëjtit nivel me personalitetet e vendit të përcaktuara në pikën 1, gërmën “a”, të këtij neni, kur vijnë në vendin tonë;
- i Objekte të tjera të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 14

Ruajtja e personaliteteve pas lënies së detyrës

- i Presidenti i Republikës pas përfundimit të mandatit gëzon të drejtën e mbrojtjes personale për pesë vjet. Në rast të ndërprerjes së mandatit, gëzon të drejtën e mbrojtjes personale për gjysmën e kohës së qëndrimit në detyrë.
- i Kryetari i Kuvendit pas përfundimit të mandatit gëzon të drejtën e mbrojtjes personale për katër vjet. Në rast të ndërprerjes së mandatit gëzon të drejtën e mbrojtjes personale për gjysmën e kohës së qëndrimit në detyrë.
- i Kryeministri pas largimit nga detyra gëzon të drejtën e mbrojtjes personale për katër vjet. Në rast të ndërprerjes së detyrës përpara mandatit qeverisës gëzon të drejtën e mbrojtjes personale për gjysmën e kohës së qëndrimit në detyrë.
- i Kohëzgjatja e mbrojtjes së personaliteteve të tjera pas lënies së detyrës nga ana e tyre, përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 15

Kohëzgjatja e ruatjes së objekteve

- i Objektet e përcaktuara në nenin 5, pika 9 dhe pika 10, ruhen dhe mbrohen deri në ndryshimin e statusit të tyre.
- i Banesa e Presidentit të Republikës, e Kryetarit të Kuvendit, e Kryeministrit ruhen dhe mbrohen gjatë kohës së qëndrimit të tyre në detyrë. Pas përfundimit të detyrës, ruajtja dhe mbrojtja e banesës bëhet për një periudhë 2-vjeçare. Në rast të përfundimit të mandatit apo të lirimit nga detyra para afatit, ruajtja dhe mbrojtja bëhet deri në gjysmën e kohës së qëndrimit në detyrë, por jo më shumë se dy vjet.
- i Kohëzgjatja e ruajtjes së banesës të personaliteteve të tjera përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU IV

AUTORITETET DHE PËRGJEGJËSITË

Neni 16

Ministri

- i Ministri ka këto përgjegjësi dhe kompetenca:
- i harton dhe mbikëqyr zbatimin e politikave të veprimtarisë së Gardës;

- i përcakton drejtimet strategjike dhe objektivat e Gardës;
- i kërkon Drejtorit të Përgjithshëm të Gardës së Republikës të raportojë për kryerjen e detyrave, si dhe për çështje të veçanta që lidhen me sigurinë e personaliteteve dhe objekteve në ruajtje;
- i ushtron inspektime në mënyrë të drejtpërdrejtë apo nëpërmjet strukturave të Ministrisë;
- i nxjerr akte administrative në ushtrimin e detyrave dhe përgjegjësive në zbatim të akteve ligjore e nënligjore në fuqi;
- i garanton bashkëpunim ndërmjet Gardës dhe strukturave të tjera të Ministrisë, institucioneve të zbatimit të ligjit, si dhe institucioneve homologe të vendeve të tjera në bazë të marrëveshjeve të nënshkruara.
- i emëron personelin e Gardës së Republikës në emërtesë të tij.
- i jep gradat për personelin e gardës, përjashtuar atij të nivelit bazë.
- i miraton strukturën organizative të Gardës
- i Ministri ushtron kompetenca të tjera të parashikuara në këtë ligj dhe në aktet nënligjore në zbatim të tij.

Neni 17

Drejtori i Përgjithshëm

- i Drejtori i Përgjithshëm i Gardës së Republikës është autoriteti më i lartë ekzekutiv, organizativ, administrativ dhe operacional, i cili përgjigjet drejtpërdrejt para Ministrit për përmbushjen e misionit të Gardës.
- i Drejtori i Përgjithshëm i Gardës së Republikës ka këto kompetenca:
 - i organizon, drejton dhe kontrollon veprimtarinë e Gardës;
 - i menaxhon burimet njerëzore, financiare dhe pasurinë e Gardës;
 - i nxjerr akte administrative bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore;
 - i i propozon Ministrit strukturën organizative Gardës;
 - i përfaqëson Gardën në marrëdhënie me institucionet e tjera brenda dhe jashtë vendit;
 - i nënshkruan marrëveshje teknike dhe operationale, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi;
 - i emëron personelin e nivelit bazë dhe jep gradat për këtë nivel.
 - i ushtron kompetenca të tjera të parashikuara me ligj dhe në akte nënligjore.

Neni 18

Kriteret e emërimit të Drejtorit të Përgjithshëm të Gardës së Republikës

- i Drejtori i Përgjithshëm i Gardës së Republikës emërohet nga Kryeministri me propozim të Ministrit dhe i jepet grada “Drejtues Madhor”.
- i Drejtori i Përgjithshëm i Gardës së Republikës duhet të plotësojë këto kriteret:
 - i Të ketë vetëm shtetësinë shqiptare;
 - i Të jetë punonjës i Gardës që mban gradën “Drejtuesi parë” ose “Drejtues i lartë”

- i Të mos ketë masa për shkelje të rënda disiplinore brenda tre viteve të fundit;
- i Të mos ketë konflikt interesi në ushtrimin e detyrës.

Neni 19

Lirimi nga detyra i drejtorit

- i Drejtori i Përgjithshëm i Gardës së Republikës lirohet nga detyra me urdhër të Kryeministrit me propozim të Ministrit.
- i Drejtori i Përgjithshëm lirohet nga detyra kur:
 - i humbet shtetësinë shqiptare;
 - i jep dorëheqjen;
 - i bëhet i paaftë nga ana shëndetësore për ushtrimin e funksionit për një periudhë kohore mbi 6 muaj;
 - i plotëson moshën për pension;
 - i i hiqet apo i kufizohet zotësia për të vepruar me vendim gjyqësor të formës së prerë;
 - i dënohet me vendim gjykate të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
 - i nuk përmbushen objektivat strategjike për shkak të performancës së ulët të tij.

KREU V

PRANIMI, FORMIMI DHE ECURIA NË KARRIERË

Neni 20

Marrëdhëniet e punës

Marrëdhëniet e punës në Gardë bazohen në parimet e mundësive të barabarta, të meritokracisë dhe mosdiskriminimit. Pranimi në Gardë kryhet nëpërmjet procesit të konkurrimit të hapur.

Me përfundimin e shkollimit bazë dhe studimeve/kualifikimeve, kursanti/studenti pranohet si punonjës i Gardës së Republikës, i jepet grada përkatëse “Inspektor” ose “Nënkomisar” dhe emërohet në detyrë”.

Punonjësi i Gardës së Republikës, pas pranimi, i nënshtrohet periudhës 1 (një) vjeçare të provës, periudhë e cila fillon në datën kur punonjësi emërohet në detyrë.

Neni 21

Kriteret e pranimi

- i Kriteret e përgjithshme të pranimi të shtetasit në Gardë janë:
 - i të jetë shtetas shqiptar;
 - i të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
 - i të jetë i pajisur me vërtetimin e besueshmërisë;

- i të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
 - i të ketë përfunduar arsimin e mesëm;
 - i të jetë i moshës 19-30 vjeç;
 - i të jetë i aftë nga ana shëndetësore për të kryer shërbim në struktura që sipas ligjit lejohet të mbajnë armë;
 - i të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtjeje penale me dashje;
 - i të mos jetë në ndjekje penale;
 - i të mos jetë përjashtuar apo larguar nga puna për shkelje ligjore apo disiplinore;
 - i të mos i jetë hequr e drejta e ushtrimit të funksioneve në administratën publike me vendim gjyqësor të formës së prerë.
- i Kriteret e veçanta të pranimit të shtetasit në Gardë janë:
 - i Shtetasi pranohet si punonjës i Gardës në nivelin bazë, kur krahas plotësimit të kriterëve të përgjithshme ka përfunduar edhe arsimimin për rolin bazë për punonjës të Policisë së Shtetit në institucionin arsimor të Policisë së Shtetit/ministrisë përgjegjëse për çështjet e rendit dhe sigurisë publike.
 - i Bazuar në nevojat e identifikuara për rekrutimin e punonjësve të nivelit të mesëm, në Gardën e Republikës, pranohen edhe shtetas që kanë përfunduar ciklin e dytë të studimeve të arsimit të lartë dhe që plotësojnë kriteret e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni. Pas përfundimit të kursit të formimit profesional, u jepet grada “Nënkomisar”.
 - i Shtetasi që ka përfunduar arsimim përkatës në institucionet arsimore homologe jashtë vendit të njehsuara me programet e institucionit arsimor të Policisë së Shtetit, Xhandarmërisë, Karabinierisë, Gardës Civile apo strukturave të tjera të njehsuara me to dhe që diplomat e tyre janë njohur dhe ekuivalentuar nga ministria përgjegjëse për arsimin.
 - i Të gjithë kandidatët fitues, pas emërimit në detyrë, ndjekin programin e profilizimit nga struktura përgjegjëse e trajnimit në Gardë.

Neni 22

Pranimi i punonjësve në funksione të veçanta

- i Për funksione të veçanta në Gardë, ku kërkohen njohuri specifike, të cilat nuk përfitohen në institucionin arsimor të Policisë së Shtetit apo në institucionet e përmendura në nenin 21 të këtij ligji, pranohen nëpërmjet konkurimit, shtetas që plotësojnë kriteret e mëposhtme;
 - i Të jetë shtetas shqiptar;
 - i Të mos jetë i përjashtuar nga institucionet e administratës shtetërore, të institucioneve ligjsbatuese dhe të mos jetë larguar nga shërbimi civil;
 - i Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
 - i Të jetë në gjëndje të mirë shëndetësore dhe i aftë për të kryer detyrën;
 - i Të ketë përfunduar ciklin e dytë të arsimit të lartë përkatës;
 - i Të ketë përvojë pune jo më pak se 5 vite në fushën përkatëse;
 - i Të mos jetë i dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë, për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- i Shtetasi që shpallet fitues pranohet në këto funksione pas përfundimit të kursit të

formimit bazë profesional në institucionin arsimor të Policisë së Shtetit/ministritë përgjegjëse për çështje të rendit dhe sigurisë publike dhe i jepet grada që korrespondon me funksionin ku do të emërohet.

- i Shtetasi i pranuar në funksione të veçanta, nuk ka të drejtë të aplikojë për ngritje në gradë/detyrë apo të transferohet në funksione të tjera për një periudhë 6 vjeçare.
- i Numri i shtetasve të pranuar sipas këtij neni nuk mund të jetë më shumë se 3 përqind e limitit të përgjithshëm organik të Gardës së Republikës.
- i Procedurat, rregullat e konkurimit, funksionet e veçanta dhe transferimi brenda funksioneve të veçanta përcaktohen me udhëzim të ministrit.

Neni 23

Pranimi i ushtarakëve të FARSH në Gardën e Republikës

- i Për plotësimin e nevojave të vecanta, mund të pranohen në Gardën e Republikës, ushtarakë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të cilët plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenin 21, përjashtuar pikën f, të këtij ligji.
- i Për ushtarakët e shërbimit aktiv, pranimi realizohet me pëlqimin e ushtarakut dhe në bazë të marrëveshjes dypalëshë ndërmjet ministrit të mbrojtjes dhe ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë.
- i Në çdo rast, pranimi, sipas pikës të këtij neni, bëhet pas nxjerrjes në lirim të ushtarakë, nga autoritetet përgjegjëse të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.
- i Pranimi realizohet mbi baza konkurimi, procedurat e të cilit përcaktohen me udhëzim të ministrit për çështjet e rendit e të sigurisë publike.
- i Kalimi nga strukturat e FARSH tek Garda e Republikës realizohet duke ruajtur dhe njohur vjetësinë e shërbimit.
- i Ekuivalentimi i gradave ushtarake me ato të gardës së Republikës bëhet duke marrë referencë vendimin e qeverisë për ekuivalentimin e gradave të Forcave të Armatosura me gradat e Policisë së Shtetit.

Neni 23

Arsimimi dhe trajnimi

- i Arsimimi kryhet në:
 - i Institucionin arsimor të Policisë së Shtetit/ministritë përgjegjëse për çështjet e rendit dhe sigurisë publike;
 - i Institucione arsimore homologe jashtë vendit, të përcaktuara në politikat e arsimimit të Gardës së Republikës.
- i Trajnimet kryhen në:
 - i Institucionin arsimor të Policisë së Shtetit/ministritë përgjegjëse për çështjet e rendit dhe sigurisë publike;
 - i Strukturat përgjegjëse të Gardës për trajnimin;
 - i Institucione të tjera arsimore brenda dhe jashtë vendit sipas marrëveshjeve dypalëshe në bazë të nevojave që i paraqiten Gardës së Republikës.
- i Garda i paraqet Institucionit arsimor të Policisë së Shtetit, çdo vit shkollor, kuotat e nevojshme për konkurim, për funksionet me gradën “Inspektor” dhe “Nënkomisar” si

dhe trajnime për ecurinë në gradë e karrierë.

Neni 24

Betimi

- i Punonjësi, në momentin e emërimit në detyrë, bën betimin dhe për këtë qëllim nënshkruan deklaratën e betimit.

Punonjësi betohet sipas kësaj formule betimi:

- i *“Si pjesëtar i Gardës së Republikës, betohem se do të jem besnik i popullit tim, trim, i disiplinuar, se do të zbatoj kërkesat e Kushtetutës e të ligjeve dhe do të jem i gatshëm përherë, duke mos kursyer as jetën për kryerjen e detyrës. Ndëshkimi më i rëndë i ligjeve le të më jepet nëse shkel këtë betim solemn! BETOHEM!”*
- i Refuzimi për të bërë betimin apo për të nënshkruar deklaratën e betimit sjell si pasojë anulimin e aktit të emërimit në detyrë.

Neni 25

Transferimi

- i Punonjësi transferohet nga një detyrë në një detyrë tjetër, brenda së njëjtës gradë që mban.
- i Punonjësi transferohet në këto raste:
 - i për nevoja shërbimi
 - i për plotësim të funksioneve organike;
 - i për arsye shëndetësore që e kufizojnë në kryerjen e detyrës aktuale.

Neni 26

Transferimi në struktura të tjera

- i Punonjësi mund të transferohet në struktura me grada në varësi të Ministrisë për çështjet e rendit dhe sigurisë publike, bazuar në kërkesat e këtyre të fundit. Ky transferim mund të jetë i përkohshëm ose i përhershëm.
- i Në rastet e transferimit, punonjësi i Gardës emërohet në funksionet e ofruara, duke i’u ekuivalentuar grada që mban me funksionet dhe gradat në institucionin ku ai transferohet, sipas politikave të përcaktuara në lëgjisllacionin e këtij të fundit.
- i Koha e qëndrimit në detyrë në struktura/institucione të tjera njihet si vjetërsi në strukturat e Gardës së Republikës për punonjësin e Gardës.”
- i Në përfundim të periudhës së qëndrimit në detyrë pranë strukturave/institucioneve të tjera, punonjësi ka të drejtë të rikthehet në strukturat e gardës, në një funksion në përputhje me gradën që mban aktualisht.”
- i Rregullat dhe procedurat për zbatimin e këtij neni përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 27

Transferimi i përkohshëm

- i Punonjësi transferohet përkohësisht në një detyrë tjetër brenda Gardës në rastet si më poshtë:
- i për zëvendësimin e përkohshëm të një punonjësi/e;
- i kur funksioni organik është i paplotësuar;
- i për përballimin e dinamikës së punës si rezultat i situatave të paparashikuara;
- i Kohëzgjatja e transferimit nuk mund të jetë më shumë se 6 muaj;
- i Gjatë kohës së transferimit të përkohshëm, punonjësit i ruhet vendi i punës dhe trajtohet me pagën e vendit të punës që ka pasur para transferimit.
- i Rregullat dhe procedurat për zbatimin e këtij neni përcaktohen në Rregulloren e Gardës.

Neni 28 Pezullimi

- i Punonjësi pezullohet nga detyra në rastet kur:
- i fillon ndjekja penale;
- i ka kryer veprime që çenojnë dinjitetin apo integritetin e Institucionit, pas njoftimit nga organet ligjzbatuese;
- i Pezullimi nga detyra për shkaqet e përcaktuara në gërmën “a” të këtij neni zgjat për aq kohë sa përfundon procedimi penal
- i Vendimi për pezullim nga detyra dhe heqjen e masës së pezullimit, bëhet me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Gardës së Republikës dhe i komunikohet punonjësit ndaj të cilit merret kjo masë.
- i Ndaj punonjësit që pezullohet nga detyra, Drejtori i Përgjithshëm i Gardës së Republikës mund të vendosë:
- i heqjen e së drejtës për të hyrë i pashoqëruar në ambientet e institucionit dhe objektet që ka në ruajtje;
- i heqjen e së drejtës për të mbajtur dokumentin e identifikimit si punonjës i gardës si dhe armatimin personal;
- i heqjen e së drejtës për të patur akses në materialet me informacion të klasifikuar;

Neni 29 Ndërprerja e marrëdhënieve të punës dhe rikthimi

- i Punonjësi i Gardës ndërpret marrëdhëniet e punës kur lirohet ose përjashtohet.
- i Punonjësi lirohet nga detyra në rastet kur:
- i mbush moshën për pension pleqërie;
- i deklarohej i paaftë për punë nga organi kompetent mjekësor;
- i i miratohet kërkesa për lirim;
- i lë shtetësinë shqiptare;

- i i hiqet apo kufizohet zotësia për të vepruar, me vendim gjykate;
- i kur bëhen shkurtime në funksionet organike dhe në numrin e përgjithshëm të punonjësve;
- i kur ka vlerësime të performacës në punë dhe rezultateve të testeve të nivelit nën mesatar për 2 vite rresht;
- i dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
- i shkel betimin;
- i cenon rëndë integritetin e institucionit.
- i nuk paraqitet në detyrë pa shkaqe të justifikuara për më shumë se 7 ditë pune;
- i Një punonjës i liruar sipas pikës 2, shkronja c dhe f të këtij neni mund të rikthehet, në strukturat e Gardës, kur krijohen vende të lira.
- i Rregullat dhe procedurat e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës dhe rikthimit, përcaktohen në Rregulloren e Gardës.

Neni 30

E drejta e informimit dhe ankimit

- i Punonjësi ka të drejtën e informimit për fillimin e çdo procedimi administrativ apo disiplinor dhe për çdo vendim përfundimtar që ka të bëjë me marrëdhëniet e punës.
- i Punonjësi, për rastet që mendon se largimi apo përjashtimi nga puna është bërë pa shkaqe të justifikuara, ka të drejtë të paraqesë ankesë sipas përcaktimeve në Rregulloren e Gardës dhe legjislacionin përkatës në fuqi.

Neni 31

Vlerësimi i punonjësit

- i Punonjësi, i nënshtrohet testeve dhe vlerësimit vjetorativ periodik dhe të vecantë të punës.
- i Elementët që testohen dhe vlerësohen, procedura dhe kompetencat për vlerësimin përcaktohen në Rregulloren e Gardës.

KREU VI

GRADAT

Neni 32

Gradat dhe hierarkia

- i Sistemi i gradave përcakton hierarkinë dhe nivelin e menaxhimit në Gardën e Republikës.
- i Paraqitja, forma dhe specifikimet teknike të gradave miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

- i Hierarkia e punonjësit të Gardës përcaktohet nga grada, nga funksioni për punonjësit me të njëjtën gradë, nga vjetërsia në gradë për punonjësit me gradë dhe funksion të njëjtë.
- i Klasifikimet e niveleve, sipas hierarkisë janë:
 - i bazë;
 - i i mesëm;
 - i i lartë;
 - i madhor

Neni 33

Emërtimi i gradave

Emërtimet e gradave sipas klasifikimit janë:

- i Punonjës i nivelit bazë:
 - i Inspektor;
 - i Inspektor i dytë;
 - i Inspektor i parë.
- i Punonjës i nivelit të mesëm:
 - i Nënkomisar;
 - i Komisar;
 - i Kryekomisar;
- i Punonjës i nivelit të lartë:
 - i Drejtues;
 - i Drejtues i parë;
- i Punonjës i nivelit madhor:
 - i Drejtues i lartë;
 - i Drejtues madhor;

Neni 34

Kriteret për fitimin e gradës

- i Ecuria në gradë e punonjësit të Gardës bëhet nëpërmjet fitimit të njëpasnjëshëm të gradave, në përputhje me kriteret e përcaktuara për çdo gradë si më poshtë:
- i të ketë vlerësim të aftësive individuale të punës (të performancës) jo më ulët se 70% të pikëve të vlerësimit të përgjithshëm, gjatë kohës së qëndrimit në gradë;

- i të ketë përfunduar arsimin dhe kualifikimin përkatës për gradën për të cilën konkurren sipas përcaktimeve të nenit 37 të këtij ligji;
- i të plotësojë kohën e qëndrimit në gradë sipas të afateve të përcaktuara në nenin 36 të këtij ligji

Neni 35

Kriteret për aplikim për gradimin e radhës

1. Punonjësi i gardës, ka të drejtë të aplikojë për fitimin e gradës së radhës kur plotëson kriteret e mëposhtme:
 - i të ketë vlerësim të aftësive individuale të punës (të performancës) jo më ulët se 70% të pikëve të vlerësimit të përgjithshëm, gjatë kohës së qëndrimit në gradë;
 - i të jetë parashkruar masa disiplinore për shkelje të rëndë, sipas afatit të përcaktuar në legjislacionin përkatës për Gardën e Republikës;
 - i të mos ketë filluar ndaj tij procedimi penal;
 - i të mos ketë filluar ndaj tij procedimi disiplinor për shkelje të rëndë;
 - i të ketë plotësuar kohën e qëndrimit në gradë sipas afateve të përcaktuara në nenin 36 të këtij ligji.
2. Konkurrimi për fitimin e gradës bëhet vetëm për gradën pasardhëse.”.

Neni 36

Afatet e qëndrimit në gradë

1. Punonjësi i Gardës për të aplikuar për gradën e radhës duhet të plotësojë afatet e mëposhtme:

a. nga “Inspektor” deri në “Inspektor i dytë”	5 vjet;
b. nga “Inspektor i dytë” në “Inspektor i Parë”	10 vjet;

Punonjësit i Gardës në nivelin bazë, që ka vjetërsi shërbimi mbi 3 vjet, i lind e drejta për të konkurruar për fitimin e gradës “Nënkomisar”;

c. nga “Nënkomisar” në “Komisar”	3 vite;
ç. nga “Komisar” në “Kryekomisar”	3 vite;
d. nga “Kryekomisar” në “Drejtues”	5 vite;
dh. nga “Drejtues” në “Drejtues i parë”	3 vite.
2. Në vjetërsinë për efekt gradimi, nuk llogaritet koha e ndërprerjes së karrierës për shkak të lejes së përfituar pa të drejtë page.
3. Në vjetërsinë për efekt konkurrimi për fitimin e gradës, llogaritet edhe koha e ndërprerjes së karrierës për shkak të:
 - a. paaftësisë shëndetësore deri në 6 muaj, brenda afatit 12-mujor;
 - b. vjetërsisë së shërbimit të njohur me vendim gjyqësor;
 - c. lejes së lindjes.
 - d. transferimit të përkohshëm në struktura të tjera.

Neni 37

Arsimimi dhe kualifikimet për fitimin e gradës

Kurset e detyrueshme për fitimin e gradës janë:

- a. për gradën “Inspektor i Dytë”, të ketë përfunduar kursin e trajnimit për Inspektor i dytë.
- b. për gradën “Inspektor i Parë”, të ketë përfunduar kursin e trajnimit për Inspektor i parë.
- c. për gradën “Komisar” të ketë përfunduar kursin e trajnimit për Komisar;
- ç. për gradën “Kryekomisar” të ketë përfunduar kursin e trajnimit për Kryekomisar;
- d. për gradën “Drejtues” të ketë përfunduar masterin profesional në fushën e rendit dhe të sigurisë publike;
- f. për gradën “Drejtues i parë” të ketë përfunduar kursin për “Drejtues të parë”.

Neni 38

Dhënia dhe fitimi i gradës

- i Gradat e nivelit bazë jepen nga drejtori I përgjithshëm I Gardës ndërsa gradat e niveleve të tjera jepen nga ministri për ceshtjet e rendit dhe të sigurisë.
- i Grada “Inspektor” i jepet punonjesit të gardës, pas përfundimit të shkollimit bazë.
- i Grada “Nënkomisar” fitohet pas shpalljes fitues në procesin e konkurrimit dhe përfundimit të ciklit të parë të studimeve të arsimit të lartë ose pas përfundimit të kursit përkatës në Akademinë e Sigurisë për konkurentët që kanë përfunduar ciklin e dytë të arsimit të lartë.”
- i Gradat “Inspektor i dytë”, “Inspektor i parë”, “Komisar”, “Kryekomisar”, “Drejtues” dhe “Drejtues i parë” fitohen nëpërmjet konkurimit për gradim.
- i Gradat “Drejtues i lartë” dhe “Drejtues madhor” jepet në momentin e emërimit të punonjesit që i korrespondojnë këto grada.
- i Punonjësi i gardës i shpallur fitues për gradën e radhës duhet të përfundojë kursin përkatës sipas përcaktimeve në nenin 37 të këtij ligji menjëherë pas miratimit të listës emërore të së drejtës për gradë.
- i Numri i punonjësve që do të ndjekin programin e shkollimit/trajnimit, nuk mund të jetë më shumë se 30% mbi numrin e vendeve të lira të shpallura për gradën përkatëse.
- i Pas përfundimit të programit të arsimit/trajnimit, renditja e konkurrentëve bëhet sipas shumës së pikëve të arritura gjatë testimit/vlerësimit dhe arsimit/kualifikimit për gradën përkatëse, duke filluar nga punonjësi i cili ka vlerësimin më të lartë, duke bërë listim të ndarë midis fituesve dhe listës së pritjes.
- i Afati i qëndrimit në listë pritje për dhënien e gradës, nuk mund të jetë më shumë se 12 muaj. Nëse brenda këtij afati nuk bëhet e mundur dhënia e gradës, punonjësi i nënshtrohet konkurimit të radhës.
- i Bazuar në aktin përfundimtar të vlerësimit, Komisioni përkatës i Gradimit, i paraqet Drejtorit të Përgjithshëm të Gradës së Republikës listën emërore të aplikantëve fitues sipas rendit zbritës dhe listën e pritjes.

Neni 39

Procedura e aplikimit dhe verifikimit

- i Drejtori i Përgjithshëm i Gardës së Republikës në varësi të nevojave të Gardës i propozon ministritkuotat për gradimet e radhës dhe afatet e këtij procesi në Gardën e Republikës.
- i Fillimi i procesit të gradimeve shpallet në faqen zyrtare të Gardës së Republikës si dhe dërgohet zyrtarisht në të gjitha strukturat e saj për mundësimin e konkurimit të personelit të interesuar jo më vonë se 30 ditë nga data e konkurimit. Për këtë qëllim mund të përdoren edhe format e tjera të komunikimit publik.

- i Procesi i gradimeve zhvillohet vetëm njëherë në vit për një gradë të caktuar dhe përfundon brenda muajit qershor të cdo viti.
- i Punonjësi që dëshiron të marrë pjesë në procesin e konkurrimit për fitimin e gradës, aplikon pranë strukturës burimeve njerëzore, brenda afatit të përcaktuar.
- i Struktura e burimeve njerëzore bën verifikimin e dokumentacionit për plotësimin e kriterëve të çdo aplikanti. Për aplikantët që plotësojnë kriteret për konkurrim për fitim grade, hartohet lista emërore me dokumentacionin përkatës. Për ata që nuk plotësojnë këto kriterë u kthehet përgjigje për arsyet e mospranimit të aplikimit.
- i Struktura përgjegjëse për burimet njerëzore dhe struktura përgjegjëse për trajnimet, pas riverifikimit të dokumentacionit të aplikantëve, harton listën emërore përfundimtare të aplikantëve që plotësojnë kriteret për konkurrim për fitim grade, duke i caktuar secilit aplikant një numër kodik identifikimi dhe ia dërgon atë strukturës përgjegjëse për menaxhimin e procesit të gradimeve.
- i Aplikanti që pas ri-verifikimit, nuk plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 35 të këtij ligji, skualifikohet. Ai njoftohet zyrtarisht për arsyet e mospranimit të aplikimit për konkurrim.
- i Aplikanti i skualifikuar ka të drejtën e ankimit, sipas përcaktimeve në nenin 40 të këtij ligji.

Neni 39

Fazat e testimit të kandidatëve

- i Për fitimin e gradës “Komisar”, kandidati vlerësohet në testimin me shkrim dhe intervistën me gojë.
- i Për fitimin e gradës “Kryekomisar” deri në “Drejtues i parë”, kandidati vlerësohet në testimin me shkrim, ushtrime vlerësuese dhe intervista me gojë.
- i Kufiri minimal për kalimin me sukses të testimit përkatës përcaktohet nga Drejtori i Përgjithshëm i Gardës së Republikës që në momentin e shpalljes së fazës së aplikimeve, por ai nuk mund të jetë më i ulët se 70 për qind.

Neni 40

Procesi i ankimit

- i Punonjësi i gardës ka të drejtën e ankimit, për çdo fazë të procesit për fitimin e gradës.
- i Ankimi bëhet me shkrim dhe i dërgohet Komisionit të Apelimit për fitimin e gradës, brenda 7 ditëve pune nga momenti i skualifikimit ose shpalljes së rezultateve të testimit.
- i Komisioni i Apelimit për fitimin e gradës, ngrihet me urdhër të Ministrit.
- i Komisioni i Apelimit shqyrton ankesat dhe merr vendim brenda 30 ditëve pune, nga data e përfundimit të afatit të ankimit.
- i Ankuesit i kthehet përgjigje zyrtare me shkrim, brenda 7 ditëve pune, nga data e marrjes së vendimit nga komisioni.
- i Formularët e vlerësimit, fletët e testimit të plotësuar në mënyrë fizike ose elektronike, nuk i jepen aplikantit dhe nuk bëhen publike.
- i Ushtrimi i të drejtës së ankimit, brenda afatit të përcaktuar pezullon nxjerrjen e urdhrat dhe efektet e aktit të vlerësimit të Komisionit të Gradimit që është ankimuar.
- i Në përfundim të shqyrtimit të ankesës së aplikantit, nëse Komisioni e vlerëson të drejtë, ai njoftohet jo më vonë se dy ditë, para datës së fillimit të fazës pasardhëse të testimit.
- i Vendimi i Komisionit të Apelimit për fitimin e gradës është i zbatueshëm menjëherë.
- i Gjatë procesit të ankimit, punonjësit e gardës i garantohet e drejta për t’u informuar, dëgjuar dhe mbrojtur, në përputhje me parimet e Kodit të Procedurave Administrative.
- i Urdhri përkatës për dhënien e gradave miratohet pas përfundimit të afateve të procesit të

apelimit”.

Neni 39

Përcaktimi i gradave korresponduese për çdo funksion

- i Çdo funksioni i caktohet grada korresponduese.
- i Përcaktimi i gradave korresponduese për çdo funksion miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU VII

TRAJTIMI I PERSONELIT

Neni 40

Koha e punës dhe e pushimit

- i Koha e punës dhe e pushimit për punonjësit, njehsohet me atë të punonjësve të tjerë të administratës shtetërore.
- i Për nevoja të punës dhe interesa të shërbimit, koha e punës ditore mund të zgjatet tej kohës normale të punës me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Gardës së Republikës ose të drejtuesit të strukturës. Në këto raste punonjësi kompesohet sipas legjislacionit në fuqi.
- i Punonjësi gëzon të drejtën e pushimit vjetor si dhe të pushimeve të tjera të pagueshme.
- i Pushimi vjetor për punonjësit e Gardës është 28 deri në 45 ditë kalendarike dhe jepet i shkallëzuar sipas funksioneve dhe gradave.
- i Kur, për arsye pune e shërbimi, pushimi vjetor nuk mund të jepet brenda vitit, ai duhet të jepet jo më vonë se muaji Mars i vitit pasardhës. Në të kundërt bëhet kompesimi në vlerë financiare.

Neni 41

Leja pa të drejtë page

- i Punonjësi gëzon të drejtën e lejes pa të drejtë page për një periudhë afatshkurtër deri në 2 muaj ose afatgjatë deri në 3 vjet.
- i Leja afatshkurtër jepet nga Drejtori i Përgjithshëm i Gardës së Republikës dhe pas përfundimit të lejes punonjësi kthehet në të njëjtën detyrë.
- i Leja afatgjatë jepet vetëm për studime nga Drejtori i Përgjithshëm i Gardës së Republikës.
- i Rregullat dhe procedurat e lejes pa të drejtë page përcaktohen në Rregulloren e Gardës.

Neni 42

Kujdesi për gratë shtatëzëna

- i Punonjëset shtatëzëna ose me fëmijë në gji nuk mund të punojnë në funksione pune që mund të dëmtojnë shëndetin e tyre dhe të fëmijës.
- i Nuk lejohet puna e natës për punonjëset shtatëzëna.
- i Funksionet që dëmtojnë shëndetin e tyre dhe të fëmijëve përcaktohen në Rregulloren e Gardës.

Neni 43

Leja e lindjes

- i Punonjëset shtatëzëna gëzojnë të drejtën e lejes së paralindjes dhe paslindjes sipas legjislacionit në fuqi.
- i Pagesa e punonjësve për rastet e lejelindjes, përcaktohet nga ligji për sigurimet shoqërore.

Neni 44

Trajtimi financiar në marrëdhënie pune

- i Punonjësi, për shkak të përgjegjësisë dhe të rrezikshmërisë së lartë në detyrë trajtohet me:
 - i paga mujore e cila përbëhet nga paga për gradë, shtesë për vjetërsi shërbimi si dhe shtesë për natyrë të veçantë pune, pagesë për dëmshmëri shëndeti, për funksione të vecanta;
 - i shtese page per punën e kryer me turne të dyta e të treta dhe mbi kohën normale të punës.
 - i trajtim me ushqim;
 - i ndihma financiare në rastet e fatkeqësive në familje;
 - i shpërblim deri në masën e tre pagave mujore
 - i ndihma e menjëhershme financiare në rast të dëmtimit të rëndë të pronës private, për shkak të detyrës, sipas akteve të vlerësimit të dëmit.
- i Punonjësi, gjatë periudhës së marrëdhënieve të punës dhe pas ndërprerjes së tyre, për të drejta që nuk parashikohen në këtë ligj, trajtohet sipas Kodit të Punës.
- i Kriteret për përfitimet sipas shkronjës “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, dhe “f”, të pikës 1 të këtij neni përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 45

E drejta për sigurim shëndetësor

- i Punonjësit e strukturave të vecanta të Gardës, në funksion të përmbushjes së detyrës së tyre, gëzojnë të drejtën për sigurimin shëndetësor për shërbime shëndetësore të cilat nuk janë pjesë e paketave të shërbimit shëndetësor, që ofrohen nga Fondi për Sigurimin e Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

- i Ky sigurim realizohet sipas kontratës së lidhur me shoqërinë e sigurimit, të përzgjedhur sipas rregullave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për prokurimin publik, i cili mbulon shpenzimet për kontrollin parandalues, diagnostifikues dhe kurues, të orfurara nga institucionet e shëndetësisë, brenda dhe jashtë vendit.
- i Lista e shërbimeve shëndetësore, autoriteti mjekësor që vendos për shërbimet shëndetësore për çdo rast, procedurat për sigurimin shëndetësor të veçantë dhe përfituesit sipas këtij neni përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 46

E drejta për sigurim jete

Punonjësi, i cili është i angazhuar në detyra me rrezikshmeri të lartë përfiton sigurimin e jetës sipas rregullave të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave.

Neni 47

E drejta për përfitim kredie me interesa të butë

- i Punonjësit të pastrehë, i jepet kredi për strehim me kushte lehtësuese nga Buxheti i Shtetit.
- i Kriteret, masa e përfitimit, interesat dhe procedura për fitimin dhe ndërprerjen e kredisë, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 48

Kompensim për strehim

- i Kur punonjësi i nivelit të mesëm e të lartë, emërohet apo komandohet në detyrë jashtë vendbanimit të përhershëm, kur nuk i sigurohet nga Garda ambient për akomodim, ai kompesohet për shpenzimet e strehimit.
- i Masa ditore e përfitimit dhe procedura e kompesimit për strehim përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 49

Mbrojtja e veçantë

- i Në rast se punonjësit apo ndonjë pjesëtar i familjes së tij i kërcënohet jeta për shkak të detyrës, ka të drejtë për mbrojtje të veçantë.
- i Kushtet dhe mënyra e mbrojtjes së veçantë për punonjësit përcaktohen në Rregulloren e Gardës.

Neni 50

Trajtimi financiar pas ndërprerjes së marrëdhënieve të punës

- i Punonjësi që ndërpret marrëdhëniet e punës me institucionin përfiton:
- i pagesë kalimtare;
- i pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi;
- i pension shërbimi;
- i pension suplementar mbi pensionin e pleqërisë;
- i Mbulim të shpenzimeve shëndetësore, për kontrollin parandalues, diagnostikues, kurues dhe të pajisjeve të ofruara nga institucionet shëndetësore, brenda dhe jashtë vendit.
- i Rregullat dhe procedurat, lista e shërbimeve shëndetësore, si dhe autoriteti mjekësor që vendos për shërbimet shëndetësore, për punonjësit që ndërpresin marrëdhëniet e punës sipas pikës 1 të këtij neni janë të njëjta me ato të punonjësve në marrëdhënie pune. Efektet financiare për përfitimin e shpenzimeve shëndetësore mbulohen nga Buxheti i Shtetit.

Neni 51

Trajtimi i familjarëve të punonjësve që humbin jetën për shkak të detyrës

- i Kur punonjësi humb jetën në krye apo për shkak të detyrës, pjesëtarët e familjes përfitojnë:
- i ndihmë të menjëhershme financiare, deri në 10 paga mujore, sipas pagës së muajit të fundit të shërbimit;
- i pension familjar suplementar në masën 100% të pagës së muajit të fundit kalendarik të shërbimit, pavarësisht nga periudha e sigurimit. Përfitimet jepen në vlerën 100 % të pagës, sa herë që paga, sipas së cilës është llogaritur ky përfitim, ndryshon;
- i rimbursim në masën 100 % të bursës së studimit në institucionet e arsimit shtetëror për fëmijët e punonjësit;
- i banesë falas për bashkëshorten dhe fëmijët kur janë të pastrehë;
- i ndihmë financiare në masën e 1 page mujore, çdo përvjetor vdekjeje;
- i ceremonia mortore organizohet nga drejtuesi i strukturës dhe shpenzimet paguhen nga buxheti i Gardës;
- i punësim me prioritet për fëmijët, në përputhje me arsimimin, përvojën dhe kritere të tjera të nevojshme për vendin e punës.
- i Familjet e shtetasve, të cilët humbin jetën për shkak të kryerjes së detyrave në ndihmë të strukturave të Gardës së Republikës, përfitojnë në mënyrë të njëjtë çdo ndihmë dhe trajtim të parashikuar në pikën 1 të këtij neni. Përfitimet për këtë kategori caktohen në bazë të pagës mujore të tyre dhe për shtetasit që nuk janë në marrëdhënie pune, caktohen në bazë të pagës mujore të gradës “inspektor”.
- i Rregullat dhe procedurat e detajuara për trajtimin financiar të familjarëve të punonjësve që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU VIII

DISIPLINA

Neni 52

Sjellja dhe etika

- i Punonjësi është i detyruar të respektojë rregullat e sjelljes e të etikës gjatë përmbushjes së detyrave.
- i Normat dhe rregullat e sjelljes dhe të etikës përcaktohen në rregulloren e Gardës.

Neni 53

Shkeljet e disiplinës

- i Shkelje disiplinore është çdo veprim ose mosveprim i punonjësit që bie në kundërshtim me këtë ligj dhe Rregulloren e Gardës.
- i Shkeljet disiplinore kategorizohen të lehta dhe të rënda.
- i Punonjësi, ndaj të cilit merret masë për shkelje të lehtë disiplinore, ka të drejtë të ankohet tek eprori i punonjësit që i ka dhënë masën, brenda 5 ditëve nga çasti i marrjes në dijeni me shkrim për dhënien e masës disiplinore.
- i Punonjësi, ndaj të cilit merret masë për shkelje të rëndë disiplinore, ka të drejtë të ankohet në Komisionin e Apelimit, brenda 10 ditëve nga çasti i marrjes dijeni me shkrim për dhënien e masës disiplinore.
- i Gjatë procesit të ankimit, punonjësit duhet t'i garantohet e drejta për t'u informuar, dëgjuar dhe mbrojtur në përputhje me parimet e Kodit të Procedurës Administrative.
- i Punonjësi ka të drejtë të ankimojë vendimin e dhënë, sipas pikave 3,4 dhe 5 të këtij neni, dhe në Gjykatën Administrative të shkallës së parë, në përputhje me legjislacionin për procedurat administrative.
- i Procedurat për zbatimin e këtij neni përcaktohen në Rregulloren e Gardës.

Neni 54

Masat disiplinore

- i Punonjësi që kryen shkelje disiplinore ndëshkohet:
- i Për shkelje të lehta disiplinore me masat:
 - i Vërejtje;
 - i Vërejtje me paralajmërim;
- b) Për shkelje të rënda disiplinore me masat:
 - i Gjobë në masën deri në 5 ditë pune;
 - i Shtyrje e afatit të gradimit deri në 2 vjet;
 - i Përgjashtim nga Gardës.

- i Masa disiplinore shuhet pas kalimit të këtyre afateve:
- i 6 muaj nga njoftimi i masës “vërejtje”
- i 1 vit nga njoftimi I masës “vërejtje me paralajmërim”;
- i pas mbarimit të afatit, pët të cilën është zbatuar masa disiplinore “shtyrje e afatit të gradimit deri në 2 vjet”
- i Efektet e masës disiplinore për punonjës in fillojnë pas përfundimit të procesit disiplinor, ku përfshihen procedurat përkatëse të ankimit.
- i Punonjësi administrativ, për shkeljet e kryera ndëshkohet me masë disiplinore të përcaktuar në kontratën e punës.
- i Procedurat për zbatimin e këtij neni përcaktohen në Rregulloren e Gardës.

KREU IX

UNIFORMA, SIMBOLET, SHENJAT DALLUESE, DOKUMENTI I IDENTIFIKIMIT DHE FESTA E GARDËS

Neni 55

Simbolet

- i Garda e Republikës identifikohet me flamurin dhe stemën.
- i Flamuri dhe stema miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 56

Uniforma dhe shenjat dalluese

- i Punonjësi kryen detyrat e shërbimit me uniformë dhe shenja dalluese të veçanta. Uniforma dhe shenjat dalluese përdoren vetëm gjatë shërbimit ose për shkak të tij.
- i Punonjës të strukturave të veçanta, të përcaktuara me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Gardës së Republikës, trajtohen me veshje civile.
- i Uniforma, shenjat dalluese dhe normat e veshmbathjes të punonjësve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 57

Dokumenti i identifikimit

- i Punonjësi, gjatë kryerjes së detyrës, identifikohet me dokumentin individual.
- i Përmbajtja dhe formati i dokumentit të identifikimit përcaktohet në Rregulloren e Gardës.

Neni 58

Festa e Gardës së Republikës

Festa e Gardës së Republikës është data 24 Qershor.

KREU X

ARMËT, PAJISJET, PAJISJET KUFIZUESE, PËRDORIMI I FORCËS DHE MJETET E TRANSPORTIT

Neni 59

Armët, pajisjet dhe mjetet

- i Punonjësi ka të drejtë të mbajë armë dhe pajisje personale.
- i Llojet e armatimit, të lëndëve neuroparalizuese, të mjeteve e pajisjeve të tjera kufizuese për përdorime forcës nga Garda, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave dhe përdoren vetëm në kuadër të detyrës.
- i Në ushtrimin e detyrës, Garda përdor mjete lëvizëse motorrike dhe për shërbime të veçanta përdoren mjete të blinduara.

Neni 60

Përdorimi i forcës

- i Punonjësi nuk e përdor forcën, me përjashtim të rasteve kur ky veprim është i nevojshëm për sigurimin e personalitete të larta shetërore dhe objekteve, për vetëmbrojtje dhe vetëm për të ndaluar aktet e dhunshme. Në këto raste, forca përdoret si mjet i fundit dhe nuk ka karakter ndëshkues.
- i Masa e forcës së përdorur është minimumi i mundshëm dhe përdoret në kohën më të shkurtër të mundshme.
- i Në çdo rast, ndalohet përdorimi i forcës për qëllime trajtimi çnjerëzor ose degradues.

KREU XI

BURIMET FINANCIARE

Neni 61

Buxheti i Gardës

- i Buxheti i Gardës është program i veçantë brenda buxhetit të Ministrisë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike.
- i Drejtuesi i këtij programi është Drejtori i Përgjithshëm i Gardës së Republikës dhe buxheti i këtij programi miratohet në ligjin vjetor të buxhetit.
- i Përgjegjësitë e Drejtorit të Përgjithshëm të Gardës së Republikës për hartimin dhe zbatimin e buxhetit, menaxhimin financiar dhe kontrollin, ruajtjen e mbrojtjen e aktiveve në përdorim ushtrohen sipas legjislacionit financiar në fuqi.

Neni 62
Donacionet dhe sponsorizimet

Garda pranon donacione dhe sponsorizime. Pranimi, administrimi dhe përdorimi i tyre bëhen në bazë të legjislacionit në fuqi.

KREU XII
CERTIFIKATAT

Neni 63
Çertifikata për shërbim të dalluar dhe karrierë.

Ministri përgjegjës për çështjet e rendit dhe të sigurisë publike dhe Drejtori i Përgjithshëm i Gardës së Republikës jep çertifikata për punonjësit e dalluar në kryerjen e detyrave si dhe për shtetas të ndryshëm që kontribuojnë për realizimin e detyrave nga Garda.

Neni 64
Llojet e çertifikatave

- i Llojet e çertifikatave janë:
- i çertifikatë për shërbime të dalluara;
- i çertifikatë karriere.
- i Rregullat, kriteret, procedurat, kompetencat për dhënien e çertifikatave përcaktohen në Rregulloren e Gardës.

KREU XIII
DISPOZITA KALIMTARE DHE ZBATUESE

Neni 65
Kalimi në sistemin e ri të gradave

Njëhsimi i gradave të fituara sipas ligjit nr. 9366, datë 31.3.2005, “Për gradat dhe karrierën në Gardën e Republikës së Shqipërisë”, me gradat sipas këtij ligji, bëhet, si më poshtë vijon:

- i Gradat: “rreshter”, “kapter i katërt”, “kapter i tretë” dhe “kapter i dytë”, ekuivalentohen me gradën “Inspektor”;
- i Gradat: “kapter i parë”, “kapter mjeshtër” dhe “kapter shtabi” ekuivalentohen me

- gradën “inspektor i dytë”;
- i Gradat: “kapter” dhe “kryekapter” ekuivalentohen me gradën “Inspektor i parë”;
 - i Gradat: “Nëntoger” dhe “Toger” ekuivalentohen me gradën “Nënkomisar”;
 - i Gradat: “Nënkapiten” dhe “Kapiten” ekuivalentohen me gradën “Komisar”;
 - i Grada “Major” ekuivalentohet me gradën “Kryekomisar”;
 - i Grada: “Nënkolonel”, ekuivalentohet me gradën “Drejtues”;
 - i Grada “Kolonel” ekuivalentohet me gradën “Drejtues i parë” dhe/ose “Drejtues i lartë”;
 - i Grada “Gjeneral”, ekuivalentohet me gradën “Drejtues madhor”.

Neni 66

Trajtimi gjatë periudhës tranzitore

- i Kalimi nga sistemi i gradave të fituara sipas ligjit nr. 9366, datë 31.3.2005, “Për gradat dhe karrierën në Gardën e Republikës”, me gradat sipas këtij ligji bëhet brenda gjashtë muajve me hyrjen në fuqi të këtij ligji.
- i Nëse numri i gradave është më i lartë se numri respektiv i funksioneve korresponduese për çdo gradë, punonjësi merr gradën që i korrespondon funksionit të lirë dhe nëse nuk pranon, ai lirohet me gradën e fituar.
- i Nëse numri i gradave është më i ulët se numri përkatës i funksioneve korresponduese për çdo gradë, kompletimi organik deri në përfundim të procesit të konkurrimit për ecurinë në gradë bëhet nga punonjës që mbajnë një gradë më të ulët se ajo që i korrespondon funksionit të pakompletuar.
- i Trajtimi financiar i punonjësve gjatë qëndrimit në punë deri në momentin e hyrjes në fuqi të akteve nënligjore përkatëse të parashikuara në këtë ligj, do të vazhdojë të bëhet sipas dispozitave të akteve të mëparshme nënligjore.

Neni 67

Rregullorja e Gardës

Rregullorja e Gardës miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 68

Nxjerrja dhe miratimi i akteve nënligjore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të pikës 2 të nenit 6, germës e të pikës 1 dhe germës e të pikës 2 të nenit 13, pikës 4 të nenit 14, pikës 3 të nenit 15, pikës 3 të nenit 26, pikës 2 të nenit 32, pikës 2 të nenit 39, pikës 3 të nenit 44, pikës 3 të nenit 45, nenit 46, pikës 2 të nenit 47, pikës 2 të nenit 48, pikës 3 të nenit 51, pikës 2 të nenit 55, pikës 3 të nenit 56, pikës 2 të nenit 59 dhe nenit 67.

Ngarkohet Ministri për çështjet e sigurisë dhe rendit publik të nxjerrë aktin nënligjor në zbatim të pikës 2 të nenit 8.

Neni 69 Shfuqizime

Ligji nr.8869, datë 22.5.2003, “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe ligji nr.9366, datë 31.3.2005, “Për gradat dhe karrierën në Gardën e Republikës së Shqipërisë”, si dhe dispozita të tjera ligjore e nënligjore në fuqi që bien ndesh me këtë ligj, shfuqizohen me hyrjen në fuqi të këtij ligji.

Neni 70 Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi _____ pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E T A R I

GRAMOZ RUÇI